



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **29.07.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negidet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiqaj, LDK;</u> | 24. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Melis Smakic, GIBI.</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | |
| 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, nënkryetari i komunës, z. Ali Nimanaj, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e gjashtë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Procesverbali

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe debatimi i ,raportit financiar TM2 (Prill-Qershor, Janar-Qershor) 2022,
4. Njoftimi me raportin përfundimtar të Auditimit të pasqyrave financiare vjetore 2021 nga ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit), Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Veprimit, për adresimin e të gjeturave nga Auditimi i PFV 2021,
5. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë e parë të vitit 2022,
6. Njoftimi me raportin e punës së NLP Ambienti për 6 mujorin e parë të vitit 2022,
7. Shpallja në diskutim publik e Projekt - Rregullores për ndarjen e bursave,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Destinimi i pronës së komunës për banim Social.
9. Miratimi i marrëveshjes me Drinin e Bardhë për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes – kullimi i tokave bujqësore,
10. Miratimi i marrëveshjes me ISEE – HSP për Fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar,
11. Miratimi i marrëveshjes me UBT për realizimin e projekteve “Smart City” , Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Strategjia e Zhvillimi të Integritetit të Turizmit, Studimi i Fizibilitetit për Zonën Ekonomike dhe e -Lejet.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi.

Kryetari i Komunës – përshëndet te gjithë të pranishmit, kam dy pika që të shtohen në rendin e ditës:

I kemi dy akte të Kuvendit të Komunës të cilat na u janë kthyer në rishqyrtim dhe të cilat i kemi obligim ligjor ti rishqyrtojmi.

1. Zgjedhja e zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete dhe
2. Themelimi i komisionit për dhenjen në shfrytëzim të pronës komunale me ankand.

I hedh në votim miratohen unanim nga anëtarët e Kuvendit,

Hedhe në miratim komplet rendin e ditës rendin e ditës Kush është për?
Miratohet unanim.

(në procesin e votimit mungojn Qerim Rexhaj)
Konstatohet që me 26 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhjen e sotme mungon z. Qerim Rexhaj pa ndonjë njoftim.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Hedh në miratim

Miratohet unanimit

Konstatohet që me 26 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 29.06.2022.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken tjetër Shqyrtimi dhe debatimi i raportit financiar TM2 (Prill-Qershor, Janar-Qershor) 2022. Fjalën ja kalon Drejtorit z. Genc Ademaj.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik, Genc Ademaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit financiar TM2 (Prill-Qershor, Janar-Qershor) 2022

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, për këtë pik nuk kam mundur të përgatitem sepse materialin nuk kam mundur ta hap, Në telefon nuk me është hapur as në lloptop nuk mu ka hapur e kam kërkuar materialin atë ditë por nuk kanë pasur letër te ma printojnë dhe për këtë pikë nuk mund të kontribuoj, po e ndie veten keq se nuk mund të diskutoj për këtë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë,

Pyes anëtarët e Kuvendit kush a ka edhe dikush diçka.

Pasi që diskutime tjera nuk ka kalojmë në piken e radhës të rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër Njoftimi me raportin përfundimtar të Auditimit të pasqyrave financiare vjetore 2021 nga ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit), Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Veprimit, për adresimin e të gjeturave nga Auditimi i PFV 2021,

Drejtori për Zhvillim E ekonomik - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit përfundimtar të Auditimit të pasqyrave financiare vjetore 2021

nga ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit), Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Veprimit, për adresimin e të gjeturave nga Auditimi i PFV 2021,

Ajshe Metaj – ky raport është diskutuar edhe në KPF, ka të gjetura disa nga to që i kam veçuar janë këto: të A1 është thënë se nuk ka regjistra kontabël për leje të ndërtimit kjo mund të diskutohet ose edhe të japin përgjigje ekzekutivi, në mënyrë që të kemi mundësi me evidentuar.

Mos verifikimi i pronave komunale në vitin 2021 thuhet se janë 20% të pronave të pa evidentuara po në vitin 2021 prej 20% janë verifikuar vetëm 4%, këtu ka humbje të mëdha ku nuk evidentohen pronat nuk mund ti mbledhim edhe parat prej pronave në këtë drejtim duhet me punuar së është shumë e rëndësishme një.

Mos përgatitja e planit vjetor për dhënien e subvencioneve, Auditori ka gjetur se nuk ka pasur një plan të përgatitur me i subvencionuar nga kjo kanë dal shumë probleme.

Pyetje për drejtorin, këto opinione në përgjithësi çfarë opinione e komunës e kam diskutuar të çështja B3 hartimi i projekteve ekzekutivë është mirë të diskutohet. Edhe Komuna që nuk ka planë për mbledhjen e llogarive. Të gjitha çështjet janë edhe në material nuk po dua ti prek si pika por në mënyrë që ti diskutojmë sepse ka shumë çka, nuk po zgjerona me shumë.

Drejtori Genc Ademaj –sa i përket rekomandimeve kemi 9 rekomandime nga viti 2019 dhe 5 nga viti 2020 gjithsejtë i kemi 14 vërejtje. (sqaron vërejtjet e auditorit te jashtëm).

Të pronat nuk kanë qen te evidentuara pronat komunale mirë po me një projekt qe e kemi pasur për evidentimin e të gjitha pronave këtu janë evidentuar edhe pronat komunale dhe është lista e pronave e cila gjindet edhe në ueb faqen e komunës.

Plani vjetor për subvencione ka pasur plan vjetor por fatkeqësisht auditori e merr vetëm planin vjetor të dorëzuar në zyrën e kryeministrit në kuadër të cilës është zyra për vetëqeverisje të mirë. Ne për këtë vit e kemi punuar ligji na obligon që prej momentit që aprovohet buxheti ose në vine buxhetore në shtator plani është punuar por nuk është dorëzuar me kohe dhe ne kemi mor vërejtje.

Niman Beqiraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, raporti i auditorit është i një rëndësie të veçantë, për shkak se edhe rekomandimet që i jep të rekomandon se si të adresohen ato rekomandime mbi 70% e gjetjeve janë të përsëritura rekomandimet nuk janë mor aq seriozisht, këto rekomandime të merren me seriozisht.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka,

Hedh në miratim planin e Veprimin për eliminimin e të gjetura të auditorit të përgjithshëm.

Hedh në votim

Miratohet unanimit nga anëtarët prezent

Të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken në vazhdim Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë e parë të vitit 2022.

Kryetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë e parë të vitit 2022.

Ajshe Metaj – kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë e Financa, të drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, thuhet se ka ngecje për hapjen e dy konkureseve për drejtor të shtëpisë së kulturës dhe vazhdimin e punimeve në sallën në fshatin Vrellë kur do të vazhdojnë ato punime, kur do të përfundojnë punimet?

Kryetari i Komunës – konkursi për Shtëpi të Kulturës është i hapur është çështje e zyrës së personelit këto procedura.

Salla sportive në Vrellë kemi komikim të vazhdueshëm të operatorin jemi duke i shikuar mundësit ligjore të cilat e obligojnë operatorin me i përfunduar punët të cilat janë të stërzgjatura ku salla po mbetet e pa shfrytëzuar nga nxënësit apo qoftë nga banoret.

Agron Gashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyetje për Kryetarin kemi parë një anketa nga një institut prestigjioz Helvetas dhe aty e shohim komunën tonë me një besueshmëri shumë të vogël kryesisht Kryetari tek pjesa e pyetjes besimit të plotë të kryetarit është 7.7% një nder komunitet e fundit nga besimi i kryetarëve.

Kryetari i Komunës - faleminderit Agron unë besoj shumë në ty se je djalë ekspeditiv por është dashur ta shikosh kohën kur ka qenë kjo anketë për punën e kryetarit, këto pyetje që janë bere nuk janë prej kohës kur ne jemi në detyrë.

Niman Beqiraj – pyetje për kryetarin a është Iliri i Istogut të fushatës dhe Iliri i qytetarëve. Në fushat ke premtuar që në ditën e parë të punës së kom me e dredh bllokuesin e ujit dhe kom me e leshu ujin mivadës. Ndërkaq janë ber gjashtë muaj dhe nuk e ke n shuar ende, mivada nuk ka ujë edhe pse është moti i nxehtë 40 gradë, nuk e di si mund të jetoj njeriu pa ujë. A është shumë e vështir me e dredh çatë a ki nevojë për far çelësi a çka është?

Kryetari i Komunës – nuk po me kujtohet dhe nuk është gjuhë e imja e komunikimit me u qu e me dredh bllokuesin e ujit nuk e di që kam thënë në këtë formë.

Shumë e vërtet që banoret e mbivades kanë probleme me ujin e pijes jo tash por një kohë kogja të gjatë krejt çka është në kompetencat dhe në detyrimet e tona i kemi ndërmarr, një komision i përbashkët mes neve dhe hidro Drinit që është në teren çdo ditë për me i eliminuar lidhjet ilegale në mënyrë që me u rrit kapaciteti i ujit për me mrri nga mivada, ka orar të reduktimeve është i publikuar në faqe të Hidro Drinit, është Nexhdet Rama i cili i ngrit me së shumti këtë çështje dhe e kemi disku.

Kemi raste kur personat e pa përgjegjshëm shkojnë e prekun kyqjët e ujit që po paraqet problem deri sa po mbërrimi në identifikimin e tyre.

Kemi pasur mungesa të hatashme të Ministrisë së Infrastrukturës deri sa e kemi marr pëlqimin për me e shpu rrugën në dy vende që me e kaluar gypin e ujësjellësit të ri.

Kompania është duke punuar me intensitet shumë të madhe për kundër çmimeve të rritura për shkak se është nevojë shumë e madhe dhe presioni jonë edhe pse nuk kemi kontratë direktë me ta, kontrata jonë është me Austriakt, kompania është nën kontraktor, dhe janë duke punuar me intensitet të madhë.

Në anën tjetër jemi duke pranuar kërkesa çdo ditë për furnizim me ujë të pijes përmes sisternave që i kemi. Është vendim që e kemi marr edhe me drejtorin e Shërbimeve Publike edhe të emergjencave që secila kërkesë që vjen nga pjesa e mivadës për furnizim me ujë me u aprovu menjëherë mendoj që janë hapa që i kemi marr në raport me premtimet e fushatës.

Çështja e çelësit dhe ujit është e Hidro Drinit nuk mund të merremi ne me caktimin e ujit se ka shkon rrjedha e ujit.

Niman Beqiraj- është e vetët që është e detyrë e Hidro Drinit mirë po në fushat ja keni marr kompetencën ke than se si të vij në pushtet dit e para kom me leshu çelësin me e ç blloku për këta pyeta pse nuk është bere që 6 muaj. Aj projekti i ujësjellësit ka qenë milionësh është bere për me i larguar këto probleme por problemet janë përsëri të njëjta.

Kryetari i Komunës – nuk jam i prirë t'ia marr kompetencat një institucioni për pos me ja respektuar dhe me i ndihmi në realizimin e të hyrave të tije e sidomos kur janë në pyetje qytetaret e Komunës së Istogut. Jam i Istogut dhe vazhdoj të jem i Istogut me probleme që ti po i përmend me ekzekutivi për dit ballafaqohemi me këta qytetar me kërkesat që ata i kanë dhe të siguroj se nuk është hiq e lehtë. E the edhe vet që është projekt milionësh edhe nder projektet që zgjedhin problem në 100 vjetet e ardhshme mendoj qe deri në 6 muaj nuk janë që ia ndërrojnë rrjedhën projektit ose që ja kontestojnë suksesin.

Ajshe Metaj – ndërrimi i dyerve në gjimnazin Haxhi Zeka ku qëndron realizimi i projektit a është gati që me u bë ndërrimi i dyerve dhe dritareve.

Naim Behlulaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, tenderi është ne fillim të gushtit ka me startuar me punë.

Negjdet Ramaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, jenësh shpall disa reduktime në fakt nuk ka as një pik ujë me javë e me muaj të tër mbivada këtu këto shpalla janë një fyerje për banoret se nuk ka pikë uji nuk ka çka redukton, është fyerje nga Hidro Drini për banoret ju mund ta evidentoni edhe vet që nuk ka ujë.

Fjolla Ukaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, në kopshtin e fëmijëve në Banjë pasi që ka hapsir ka klasë të lirë dhe grup moshat 9 muaj deri 3 vejte, a ka buxhet komuna që me marr edhe ni motër edukatore shtesë pasi që hapsir në objekt ka të mjaftueshëm.
Kam biseduar dje me drejtoreshën me ka thënë që edhe ajo ka bere kërkesë

Naim Belulaj – mjete financiare kemi por për shkak të numrit të madh të mësimdhënësve nuk po na lejon Ministria dhe për ata nuk po mund të dërgojmë edukatore. Jemi duke bër kërkesa për me e rrit numrin e edukatoreve neper kopshte.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit anëtarët e kuvendit, a ka dikush diçka, pasi që diskutime tjerët nuk keni kalojmë në piken tjetër të rendit të ditës.
Konstatohet që me 23 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e gjatë Njoftimi me raportin e punës së NLP Ambienti për 6 mujorin e parë të vitit 2022,

Alferd Tahirsylaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit të punës së NLP Ambienti për 6 mujorin e parë të vitit 2022.

Negjdet Ramaj – q far kriteri duhet të plotëso një qytetar që të mund të aplikoj dhe punësohet ne KRM Ambienti? Ne KRM Ambienti edhe në Hidro Drin të punësuarit e shfaqin militantizmin e partisë që është në pushtet. A keni menduar në të ardhmen kjo praktik me ndryshuar pasi që kanë ndodhur disa punësime se njihen ata persona me emra dhe mbiemra.

Alferd Tahirsylaj – konkurset i qet Peja çdo pozitë i ka kriteret e veta dhe kush i plotëson hyn në punë, Peja i kryen të gjitha procedurat e rekrutimit, për çdo pyetje mund ti drejtohesh edhe zyrës ligjore.

Haki Podrimaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, KRM Ambienti e bëjnë një punë të mirë vetëm le të vazhdojnë kështu.

Pse janë hekur kontejnerët, jam duke i parë punëtorët, a kini buxhet që të shtohet edhe ndonjë punëtor sepse janë duke hekur keq është volumi i madh i punës me vetëm dy punëtor.

Alferd Tahirsylaj – po për punëtorët është pak punë me e lehtë kjo, se kontejnerët e mëdhenj edhe kanë mbajt tepër erdh të keqe edhe mbeturinat janë shkep për rreth kontejnerit. Pozita të hapura për punëtor nuk ka për momentin.

Fjolla Ukaj – në Banjë të ambulanta ka qenë kontejneri tani është hekur aty gjuhen edhe mbetje të cilat i shfrytëzojnë motrat medicinale dhe mjeket po në atë pjesë tash njëjtë vend qytetaret po vine e po hedhin mbeturina, qet endacak po i hapin krejt dhe po behet si një deponi mbeturinash është të trafo menjëherë para ambulantes.

Kryetari i Komunës – të pjesa e mbeturinave medicinale është një marrëveshje me spitalin rajonal të Pejës për asgjësim të mbeturinave medicinale, nuk e besoj që ka mbeturina medicinale që hedhën nga stafi i ambulanca aty, sepse ato janë mbeturina që duhet të asgjësohen.

Alferd Tahirsylaj – ne aty e kemi hek kontejnerin me shumë së një vite kontejneri ka qenë vetëm për ambulant, por qytetaret e kanë shfrytëzuar ata, dhe me kërkesë të ambulantes është hekur aj kontejner.

Fjolla Ulaj – kërkesa ime ke a mund ta kthejmë prape një kontejner të tillë, së të gjithë qytetaret po i hedhin mbeturinat në vendin e njëjtë me qese askush nuk i qetë para shtëpive. Dhe e keqja është se aty po i hapin qentë dhe komplet ajo pjesë po mbushet me to.

Alferd Tahirsylaj – ne ato ditë që i kemi për mbledhjen e mbeturinave po mundohemi të vimi me kohë. Pjesa tjetër është vetdisimi i qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që diçka tjetër nuk ka rrethe këtij raporti kalojmë në piken e radhës.

Konstatohet që të pranishëm në sallën e Kuvendit ishin 23 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë në piken tjetër Shpallja në diskutim publik e Projekt - Rregullores për ndarjen e bursave.

Kryetari i Komunës - prezanton Projekt - Rregullores për ndarjen e bursave.

Agron Gashi – kan ndryshime të mira në këtë rregullore e kam lexuar edhe atë të mëhershmen. Mirë po janë disa që dalin pas konkursit që nuk janë të specifikuara ato kisha pas dëshirë ti di edhe ti mënjanojmë.

Në konkursin e fundit për ndarjen e bursave kanë qenë disa kritere që i kanë dëmtuar studentët tanë dhe me herët në komision sidomos të kriteri i noterizimit të diplomave ka krijuar shpenzime shumë të mëdha për studentet, ne nuk kemi noter në Istog, por edhe të pjesa e ATK-së edhe ajo na ka nxjerr shumë problem studentet është dashur të shkojnë një ose dy here së paku në Pejë me i nxjerr këto dokumente plus transporti e shpenzime tjera, që ka pas shpenzime bukur shumë gati çdo student i ka harxhuar nga 50 euro në këtë konkurs, shpenzime të pa nevojshme. Janë dëmtuar shumë studentet me këtë Rregullore. Pjesa e ATK-së mendoj që duhet të hiqte krejt nga Rregullorja ne e kemi këtu Entin e Punësimit që mund ta vërtetoj ose të lëshoj vërtetime se a janë prindërit (familjaret siç kërkohen me rregullore) në punë ose jo, sepse ATK-ja po nxjerrët online dhe nuk po e specifikon a është në punë prindi ose jo. Këto mund të nxirren në Istog pa pagës mos të dëmtohen studentet.

Zyrtari që i pranon dokumentet ti kontrolloj dokumentet dhe nëse ka diçka që mungon ta udhëzoj studentin që ta bashkangjijt edhe atë dokument, e jo pasi të kryhet konkursi sepse pastaj po deshprohen për një dokument të thjesht që se nuk ka mundur me e sjell. Shpallja e konkursit të barazpeshimi i fakulteteve shumë komuna e aplikojnë këtë p.sh nëse komuna ndan 100 bursa ndahen me përqindje të caktuar në bazë të fakulteteve. Këtu në Rregullore nuk po specifikohen të ndahen në të gjitha fakultetet varësisht nga kriteri i tyre.

Të nota mesatare ne si komision kemi pasur probleme ata që kanë pas mbi 9 ne nuk i kemi pranuar, këtu e pash që nota mesatare mbi 9 vlerësohet 30 pikë me e hjek si kriter krejt sepse automatikisht aj që e ka notën mbi 9 merr bursë nga fakulteti. Shtimi i bursave. A kanë me u shtuar bursat?

Kryetari i Komunës – faleminderit për pyetjet, Ndryshimi i kësaj Rregullore është edhe rritja e numrit të bursave, do ta shikojmë edhe bazat ligjore a mund ta heqim noterizimin e diplomës për shkak që të mos krijojmë shpenzime për studentet.

Është shumë e arsyeshme të kërkohet nga enti i Punësimit një vërtetim ku shihet se a i punojnë prindërit ose jo studentit i cili ka apliku për bursë.

Edhe kjo që secili student që aplikon duhet ti kontrollohen dokumente edhe të udhëzohet nëse i mungon diçka.

Naim Belulaj – ne me kriteret e kësaj Rregulloreje jemi konsultuar me komisionin dhe ekspertet nga ministria të cilët na kanë udhëzuar. Pajtohem që të hiqte ATK-ja. Sa i përket noterizimit nuk është në Rregullore kjo është çështje e Administratës që po ua lyp me u dorëzuar diplomat të noterizuara. Për ne është valide e vulosur nga Komuna.

Haki Podrimaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, ne pajtohemi që kjo të shkoj në diskutim Publik pastaj kthehet prap në komitet dhe në Kuvend ku mund të diskutojmë dhe të vendoset. Edhe unë kam vërejtjet e mija menjëherë të neni 1 aty ka diskriminim. Mirë po pas dëgjimit publik do ti shpalos vërejtjet e mija.

Ajshe Metaj – parafolësit tjerë i paraqiten disa gjëra të cilat e lehtësojnë ose e shkarkojnë nga gjerat formale Rregulloren. Studentet me notën 9 automatikisht marrin bursë universitare, nuk e di sa i verifikoni ju ata , të hiqet kjo dhe tu jepet mundësia atyre që kanë notën me të vogël.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush diçka rreth kësaj pike?

Hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët prezent.

Të pranishëm në sallën e Kuvendit janë 22 anëtar .

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë në piken tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Destinimi i pronës së komunës për banim Social.

Kryetari i Komunës – bën prezantimin dhe sqarimin e Propozim – Vendimit për Destinimi i pronës së komunës për banim Social.

Hajrush Shoshi – a do të jetë ajo pjesë me ndërtim të lart që ta kemi parasysh kur të punohen hartat zonale mos të na ikën aj detaj.

Kryetari i Komunës – po z. Hajrush e kemi pasur parasysh dhe bashk me profesorët e kompanisë të cilët janë duke e i punuar hartat zonale e kemi fut si zonë shërbyese në të cilën përfshihen edhe banesat e karakterit social, kryesisht ndërtesa që janë në shërbim të komitetit – qytetarëve të Komunës së Istogut.

Ajshe Metaj – nëse nuk ka ndonjë pengës ligjore është e mirëseardhur, sepse në komunën ton ka mjaftueshëm raste dhe është e mirë së ardhur.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka pasi që nuk ka e hedh në miratim

Miratohet unanim nga anëtarët prezent ne mbledhje.

Konstatohet që janë 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në sall.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Miratimi i marrëveshjes me Drinin e Bardhë për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes – kullimi i tokave bujqësore.

Nënkryetari i Komunës – bën prezantimin dhe sqarimin e marrëveshjes me Drinin e Bardhë për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes – kullimi i tokave bujqësore.

Agron Gashi – sa jem i informuar është krijuar një projekt me ministrin e bujqësisë ku e ka fituar komuna me jazin e Gogës dhe këto pjesë, dëshiroj ta di pse është hy në pastrim jazi i Gogës që është 5 mijë euro vlere dhe pjesa deri në Tomoc ku këto dy projekte janë në atë projektin e ministrisë që është 300 e ca mijë euro që e ka fituar komuna.

Kryetari i Komunës – kjo çështje është diskutuar edhe neper takime tjera jazi i Gogës pjesa me e madhe e tije është e ndërtuar ka nevojë ende sepse ka shumë sipërfaqe bujqësore që me shumë vështirësi po bëhet ujitja. Ka me të vërtet nevojë për pastrim.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Atëherë e hedh në votim, kush është që të miratohet marrëveshja me Drinin e Bardhë për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes – kullimi i tokave bujqësore, Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që me 21 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 10

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë piken e radhës Miratimi i marrëveshjes me ISEE – HSP për Fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar .

Kryetari i Komunës – bën prezantimin dhe sqarimin e marrëveshjes me ISEE – HSP për Fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar.

Ajshe Metaj – kjo marrëveshje e qëlluar ne as nuk do ta diskutojmi, sepse këta persona kanë nevojë për çdo gjë, e në të gjitha fushat. Pyetje në komunën ton a ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara ?

Kryetari i Komunës – po kemi .

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar për sqarimin! A ka dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Atëherë e hedh në votim, kush është që të miratohet marrëveshjes me ISEE – HSP për Fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar,, Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që me 21 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 11

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë piken e radhës Miratimi i marrëveshjes me UBT për realizimin e projekteve “Smart City” , Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Strategjia e Zhvillimi të Integritetit të Turizmit, Studimi i Fizibilitetit për Zonën Ekonomike dhe e -Lejet.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik Genc Ademaj – bën prezantimin dhe sqarimin e marrëveshjes me UBT për realizimin e projekteve “Smart City” , Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Strategjia e Zhvillimi të Integritetit të Turizmit, Studimi i Fizibilitetit për Zonën Ekonomike dhe e -Lejet.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtorin për sqarimin! A ka dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Atëherë e hedh në votim, kush është që të miratohet marrëveshja me UBT për realizimin e projekteve “Smart City” , Strategjia e Zhvillimit

Ekonomik Lokal, Strategjia e Zhvillimi të Integritetit të Turizmit, Studimi i Fizibilitetit për Zonën Ekonomike dhe e -Lejet,
Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që me 22 anëtar janë të pranishëm në sallë

Shqyrtimi i pikës 12

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken e radhës, rishqyrtim i vendimit për Zgjedhja e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të komunës së Istogut, e propozuar nga Kryetari i Komunës. Ku Ministria e ka kthyer si të pa ligjshëm në rishqyrtim.
Por me propozim të ekzekutivit dhe disa nga anëtarët e Kuvendit.
I propozuar për zëvendës kryesues është z. Melis Smakic anëtari me i votuar nga radhët e komiteteve në Kuvendin e Komunës së Istogut. Melisin e kemi koleg këtu e njohim të gjithë.

Kryetari i Komunës – sqaron rishqyrtimin e vendimit për Zgjedhja e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të komunës së Istogut.

Niman Beqiraj – ne e kemi diskutuar edhe atë ditë çështjen e zv. Kryesuesit 10% është e vërtet që komuna e Istogut nuk i ka 10% të popullsisë komunitete ne do ta mbështesim këtë por me kushtin që kryetari do të na tregoj së për shkak politik po bëhet dhe votës që po ju vyen në asamble. E jo për shkak të diskriminimit pozitiv.

Kryetari i Komunës – mos të kishim pasur brenda ekzekutivit nënkryetarin për komunitete, ndoshta politikisht kishe pas të drejt me e menduar këtë por zgjedhja e tijë paraprakisht e rrezon këtë tezë politike.

Haki Podrimaj – asnjë dëme nuk i behet Kuvendit të Istogut që ta kemi një zv. Kryesues nga radhët e komitetit, është koleg i jonë asmblesit jam për me e votua dhe me e përkrah.

Hajrush Shoshi – materialin që e ka kthye ministria është dashur që ta kemi paraprakisht të gjithë asamblistët kishte qenë mirë.

Agron Gashi – ne jemi me i përkrahe komunitetet mirë po që e kanë kthye ministria një here a do ta kthejnë prape ata?

A ka dikush diçka?

Pasi që diskutime nuk ka hedh ne votim kush është për?

Zgjidhet z. Melis Smakic Zëvendës Kryesues i Kuvendit të komunës së Istogut.

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit të komunës.

20 anëtar prezent në sall.

Shqyrtimi i pikës 13

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës, Rishqyrtimi i vendimit për themelimin e komisionit për dhenjen në shfrytëzim të pronës komunale me ankand. Edhe këtë pik na kanë kthyer në rishqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit - pasi që diskutime tjera nuk ka, kush është ke ky komision të rishqyrtohet

Hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët prezent ne mbledhje Rishqyrtimi i vendimit për themelimin e komisionit për dhenjen në shfrytëzim të pronës komunale me ankand.

Edhe këtë pik na kanë kthyer në rishqyrtim

Prezent sa sallë 22 anëtar të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit , falënderon të gjithë për durimin që patën, edhe pse në mbledhje vetëm 22 anëtar janë nuk është në rregull .

E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:10

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**



**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**

